



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.957/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami ne çështjen juridike përmbareme të kreditorit “U-Unique” Shpk, me seli ne Prishtinë rr.”Holger Petersen” pn, me nr. Biznesi 810147513, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.S. avokat nga Prishtina, ndaj debitorit Komuna e Prishtinës, me bazë juridike përmbareme, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1470/22 te datës 30.05.2023, me datën 06.09.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Prishtinës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhoma e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1470/22 te datës 30.05.2023 , **Vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1470/22 te datës 30.05.2023, e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbaremit P.nr.394/21 dst.18.08.2021 te Përmbaremit Privat Ilir Z. Mulhaxha, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbaremit P.nr.394/21 dst.18.08.2021 ndërsa debitorin e ka detyruar qe ne emër te shpenzimeve për përpilim te përgjigjes ne prapësim ti paguaj kreditorit shumen prej 208 euro ne afat prej ditësh pas plotfuqishmërisë e këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te cenimit thelbësor te dispozitave te KPP, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë, aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe propozimin për përmbaremit ta refuzoj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremitore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori më datën 18.08.2021, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës me nr.2-210-001-21 dt.02.06.2021. Përmbarruesi Privati Ilir Mulhaxha nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.394/21 dt.18.08.2021, ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit nga fatura e cila derivon nga kontrata “Realizimi i masave të efikasitetit të energjisë në ndërtesën e banimit në bashkëpronësi”, me nr. prokurimi 616 19-214-521 situacioni i parë, t’i paguaj shumën prej 29,914.30 euro, me kamatë prej 8% e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Kundër urdhrin përmbarrimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 24.08.2021, arsyetimin se urdhri përmbarrimor është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm sepse nuk i mbështetur në asnjë dispozitë ligjore, fatura e bashkangjitur nuk është dokument i besueshëm dhe ekzekutiv ashtu siç parasheh neni 22 lidhur me nenin 29 të LPP sepse e njëjta duhet të jetë e nënshkruar nga të dy palët po ashtu të dihet edhe burimi i asaj fature, propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 38 dhe 40 par.1 nenpar.1.1, 1.2 e 1.3 të LPP. Fatura nuk përmban elementet e detyrueshme siç kërkohet me nenin 22 të rregullës financiare nr.01/2013 MF, Kreditori nuk ka dhënë ndonjë provë se punët e kryera janë konstatuar nga menaxheri i kontratës si një nder kushtet themelore për pagesën e vlerës së kontraktuar, andaj si të tillë e bënë të pa ekzekutueshëm këtë propozim. Fatura është në kundërshtim edhe me nenin 20 të UA nr.15/2010 të nxjerr nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës. Propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbarrimor ta shfuqizoj dhe ta obligoj kreditorin të kompensoj debitorin shpenzimet e procedurës në përpilimin e këtij prapësimi.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka paraqitur kreditori me datën 26.08.2021, me pretendimin se në prapësimin e debitorit nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP. Propozimi për përmbarrim është iniciuar në bazë të nenit 29 të LPP, faturën e ka pranuar debitori në mënyrë të rregullt dhe e njëjta është protokolluar me nr. Prot.05-422-01-107189/21. Sqaron se kreditori ka shkruar të debitorit e ka dorëzuar lëndën dhe në bazë të shkresës së titulluar Akt përcjellës për pagesë dt.16.06.2021, këtë shkresë e ka lëshuar debitori dhe në këtë shkresë është cekur përveç tjerash përbëjnë edhe Shtojcë: Konstatimi i organit mbikëqyrës, Stacioni dhe Fatura në tre kopje. Propozimi përmbanë të gjitha elementet e parapara me dispozitë ligjore, andaj propozon që gjykata ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa urdhri përmbarrimor të lihet në fuqi dhe të detyrohet debitori që të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkalles së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPK.nr.1470/22 të datës 30.05.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, ka lënë në fuqi urdhrin përmbarrimor dhe ka detyruar debitorin që kreditorit të paguaj shpenzimet e përpilimit të përgjigjes në prapësim duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Gjykata me rastin e vendosjes i referohet neni 69 dhe 71 të LPP duke e refuzuar si të pabazuar pretendimet e debitorit, arsyeton se fatura mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarrimi është dokument ekzekutiv konform nenit 37 dhe 29 të LPP sepse i ka të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm dhe i plotëson kushtet ligjore për përmbarrim pasi është dorëzuar në mënyrë të rregullt, mban vulën e debitorit dhe nuk është kontestuar nga debitori, andaj bazuar në këto arsye edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Dhoma e Shkalles e Dytë, e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore, kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrorit të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, në mbështetje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, kjo faturë ka cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe e njëjta si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të njëjtit ligj. Propozimi për përmbartim i ushtruar nga kreditori, po ashtu rezulton të jetë në pajtim me nenin 37 të LPP-së e cila thotë se *“kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimi të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Në rastin konkret Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkalles se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe se e as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkalles se dytë vlerëson se në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës nr.2-210-001-21 dt.02.06.2021, të cilën kreditori ia ka bashkëngjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbartim, janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbartimit dhe se kjo faturë ligjërisht paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit, e njëjta derivon nga Kontrata *“Realizimi i masave të efijences se energjisë në ndërtesën e banimit në bashkëpronësi”*, nr. prokurimi 616 19-214-521 situacioni i parë, në të cilën janë paraparë edhe kushtet, të drejtat dhe detyrimet e palëve ndërgjyqjësë. Edhe kjo gjykatë e pranon përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sepse bazuar nga fletë dërgesa për dorëzim personal që gjendet në lëndë rezulton se kjo faturë është pranuar nga debitorit me datën 19.08.2021. Fatura i plotëson kushtet ligjore nga neni 29 par.3 i LPP i cili thotë, se: *“Dokumentit të besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitorit, si dhe objekti, shumat dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar, sepse në rastin konkret fatura është e vultur me nr. Protokollit 05-422/01-107189/21 dt.10.06.2021 nga organi kompetent i debitorit Komuna e Prishtinës si Institucion Publik, element ky bazë që shpreh vërtetësinë dhe autenticitetin e një dokumenti, se e njëjta është pranuar në mënyrë të rregullt dhe është evidentuar në regjistrat e institucionit. Po ashtu kjo faturë plotëson kushtet edhe nga neni 37 i LPP i cili thotë, se: “kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti i tillë*

original apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”, ashtu që e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarrim në kopje të vërtetuar nga zyra noteriale e noterës Valbona Y. Murtezi-Bytyqi, me seli në Prishtinë. Gjykata e shkallës së dytë i analizoi edhe pretendimin ankimor të debitorit së gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar gjendjen faktike, por vlerësoi se ky pretendim nuk qëndron, po ashtu i analizoi edhe pretendimet tjera të debitorit por i vlerësoi si të paqëndrueshme dhe të paargumentuara në prova konkrete ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, dhe se të tilla nuk ndikojnë në një vendosje ndryshe për çka kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara, ndërsa aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë e vërtetoi.

Përndryshe, në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.957/23 me datë 06.09.2023**

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**